

H Y R J E



Në mbështetje të Nenit 2, paragrafi i parë, shkronja "b" të Ligjit "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nisës së lirë të veprimtarisë private të pavarur dhe privatizimit", Nr.75I2, datë 10.08.1991 dhe të Ligjit Nr.7632, datë 04.11.1993, që rregullon pjesën e parë të "Kodit Tregëtar, personat fizikë :

1) Ismail Hoxha, i biri i Qshmanit, i datlindjes 25.11.194 me adresë banimi në Tiranë, Rruga Shtjefen Gjecovi nr 18 me letërnjoftimi AZ Nr. 0060487, lindur në Tiranë;

2) Teuta Hoxha, e bija e Xhemalit, e datlindjes 14.01.195 me adresë banimi në Tiranë, Rruga Shtjefen Gjecovi nr 18 me letërnjoftimi AZ Nr. 475790, lindur në Tiranë,

mbi bazën e vullnetit të tyre të lirë dhe të zotësisë juridike për të vepruar, kanë vendosur të lidhin kontratën sa vijon

K O N T R A T E

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË TREGËTARE

"ALBAN TOURIST" SH.P.K.

I. DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1


Ortakët krijojnë Shoqërinë e Përbashkët Private me mjetet e tyre.

Neni 2

Nga Neni 1 i kësaj kontrate, Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj, të përcaktuar në këtë kontratë, me emërtimin : "ALBAN TOURIST" SH.P.K.

Neni 3

Shoqëria ka cilësinë e personit juridik me përgjegjësi të kufizuar, SH.P.K.



Neni 4

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga "Shtjefën - Gjeçovi" Nr.18.



Neni 5

Shoqëria ka vulën e saj. Vula ka formën e rrumbullakët dhe, rreth e qark së cilës është shkruar teksti :

"SHOQËRIA TREGËTARE "ALBAN TOURIST" TIRANË"

Fjala "TIRANË", është shkruar në mes të rrethit.

II. OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 6

Shoqëria Private "ALBAN TOURIST" SH.P.K., ka për objekt të veprimitarisë së saj :

Organizimin kryesisht të aktiviteteve turistike, brënda dhe jashtë Shqipërisë, për nënështetas të huaj dhe vendas, duke marrë përsipër të gjitha shërbimet turistike që kërkohen si :

- Organizimi i udhëtimeve turistike brënda dhe jashtë vëndit.
- Rezervimi i vëndeve të fjetjes në hotele, motele, fshatra turistike e banesa private.
- Rezervime të restoranteve, sallave për takime e konferenca.
- Rezervime të të gjitha llojeve të mjeteve të transportit tokësor, detar, ajror.
- Organizim të vizitave në pika turistike, historike dhe arkeologjike.
- Organizimi i çfaqjeve artistike kulturore.
- Organizimi i aktiviteteve turistike sportive : ujore , malore e ajrore.
- Transport turistik posagjersh, bagazhe e mallra me mjetet e veta transportuese tokësore, detare e ajrore.

[Handwritten signature]
[Handwritten initials]

[Handwritten signature]

-Marrje e dhënie me qira të mjeteve të transportit, shtëpi, hotele, bare, restorante e objekte të tjera të ngjashme.

-Plotësimi i formaliteteve për marrjen e vizave turistike të klientave.

-Kryerje shërbimesh portuale dhe aeroportuale për anije, tragete e mjete të tjera lundruese dhe, mjetet e transportit ajror që kontraktton Shoqëria, gjithënjë në kuadrin e aktivitetit që ajo zhvillon.

-Mbarështrimi i faunës dhe florës, sipas plan - biznesit të Shoqërisë për interesa turistike, si dhe organizimi i gjetisë turistike sportive.

-Kryerje shërbimesh konsulence e komisionere në fushën e turizmit e të aktiviteteve të tjera ekonomike sociale.

-Bashkëpunimi e pjesëmarrje me partnerë vendas e të huaj, në aktivitete dhe investime në fushën e turizmit dhe në fusha të tjera të lidhura me turizmin.

Neni 7

Shoqëria Private "ALBAN TOURIST" SH.P.K., ushtron veprimtarinë e saj të përcaktuar në Nenin 6 të kësaj Kontrate, në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj, për të realizuar veprimtarinë e parashikuar.

Për realizimin e kësaj veprimtarie, Shoqëria mund të hapi dyqane, për aktivitet të mirëfilltë tregëtar, Zyra përfaqësimi, apo dhe Filiale të saj, brënda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, selinë dhe veprimtarinë e saj, vetëm me pëlqimin e Ortakëve.

Neni 8

Shoqëria Private "ALBAN TOURIST" SH.P.K., i ka të gjitha autorizimet për të vepruar me persona të tretë privatë ose shtetërorë

vëndas dhe të huaj. Për detyrimet e veta, të krijuara në veprimtarinë e saj me persona të tretë, Shoqëria përgjigjet në bazë të pasurisë së vënë, që formon kapitalin shoqëror të themelimit.



III. MJETET E NDERMARRJES

Neni 9

Ortakët i sigurojnë mjetet (kapitalin) për krijimin dhe fillimin e punës së Shoqërisë, me shumën fillestare prej 500.000 lekësh.

I gjithë kapitali themeltar ndahet në 100 kuota.

Pjesëmarrja e Ortakëve në këto pjesë dhe në kontribute është :

1) Ismail Hoxha kontribon me 255.000 lekë dhe, disponon kuotat me Nr. serie nga 1 deri në 51 të Serisë.

2) Teuta Hoxha kontribon me 245.000 lekë dhe, disponon kuotat nga Nr. 52 deri në 100 të serisë.

Kuotat që vërtetojnë kontributin fillestar të Ortakëve themelues, janë të disponueshme dhe të kundra firmosura midis palëve, në prani të një Noteri.

Mjetet e përmendura në paragrafin e parë të këtij Neni, Ortakët do ti paguajnë pranë Noterit që vërteton këtë kontratë.

Neni 10

Ortakët mbajnë të drejtën e pronësisë në kuotat e përcaktuara në Nenin 9 të kësaj kontrate, të investuara për krijimin e kësaj Shoqërie.

Shoqëria do të ketë numur llogarie në Bankën e Shtetit Tiranë dhe në çdo Bankë tjetër private të njohur me ligj.

Neni 11

Shoqëria Private "ALBAN TOURIST", do të fillojë aktivitetin e saj, pasi të bëhet regjistrimi i saj në Gjykatë dhe të marrë miratimin e organeve kompetente, në bazë të Legjislacionit Shqiptar në fuqi.

4

Neni 12

Zgjerimi i aktivitetit të Shoqërisë ose prishja e saj, do të bëhen në përputhje me Ligjin "Për Shoqëritë Tregëtare".



IV. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË "ALBAN TOURIST"

Neni 13

Shoqëria "ALBAN TOURIST" zhvillon veprimtarinë e vet në përputhje me këtë kontratë, statutin e saj dhe me legjislacionin Shqiptar.

Ortakët drejtojnë veprimtarinë e Shoqërisë, duke u mbështetur në të drejtën e tyre të pronësisë private në mjetet e investuara në Shoqëri.

Neni 14

Mënyra e drejtimit dhe përfaqësimit të Shoqërisë "Alban - Tourist", do të kryhet në bazë të statutit të saj.

Secili nga ortakët ka të drejtë të largohet nga kjo Shoqëri me dëshirën e tij, por me kusht që më parë të njoftojë ortakun tjetër me shkrim, të paktën 1 muaj përpara. Në këtë rast, ai ka të drejtë të marrë pjesën e tij të fitimit sipas kapitalit të futur fillimisht, pasi të jetë përvehtësuar likuidimi prej tij, i detyrimeve eventuale nga Banka.

V. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Neni 15

Organet drejtuese të Shoqërisë "ALBAN TOURIST" janë :

- Asambleja e Ortakëve Themelues
- Administratori
- Drejtori i Shoqërisë

Fushë veprimi i organeve të përcaktuara në paragrafin e parë të këtij Neni, si dhe ato të përcaktuara në Nenin 13 të kësaj Kontrate, përcaktohen hollësisht në Statutin e Shoqërisë.

Neni 16

Administratori i Shoqërisë caktohet nga Asambleja e



Ortakëve; po ashtu dhe zëvendësi i tij.

Drejtori i Shoqërisë emërohet po nga Asambleja e Ortakëve me propozim të Administratorit të Shoqërisë.

Ortakët Themelues buan dakort, që Administrator i Shoqërisë të emërohet Ismail Hoxha.

Neni 17

Asambleja është organi më i lartë i Shoqërisë dhe, çdo vendim i saj është kolegjal.

Administratori dhe Drejtori i Shoqërisë, përfaqësojnë Shoqërinë brënda autorizimeve të Asamblesë së Ortakëve.

Neni 18

Asambleja vendos për problemet e zakonëshme dhe të jashtë zakonëshme. Ajo vendos me ndërhyrjen me votë favorizuese, me të paktën 51 % të kapitalit.

Asambleja mbledhet 1 herë në vit dhe, të paktën 1 herë në 4 muaj bën bilançin e Shoqërisë.

Neni 19

Administratori i Shoqërisë, ka të drejtë të merret me të gjithë veprimtarinë e Shoqërisë, të marrë në punë persona të ndryshëm, që i nevojiten Shoqërisë, me kontratë të rregulltë; të lidhë marrëveshje me persona të tretë fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj. Për lidhje marrëveshje ortakërie me firma, persona fizikë dhe juridik vendas ose të huaj, duhet të marrë pëlqimin e Asamblesë së Ortakëve.

Pranohet nga Ortakët, që Administratori i Shoqërisë, ka si organ ekzekutiv të tijin Drejtorin e Shoqërisë dhe, si i tillë, mund ti delegojë atij, ato kompetenca që shikohen të arsyeshme nga ai.

VI. FITIMI I SHOQËRISË

Neni 20

Shoqëria "ALBAN TOURIST" krijon fitimin e saj, me ushtrimin e veprimtarisë, të përcaktuar në këtë kontratë dhe në Statutin e saj. Fitimi përcaktohet nga bilançi 4 mujor i Shoqërisë.

Neni 21

Pas përballimit të detyrimeve, taksave, tatimeve dhe shpe-
zimeve të tjera nga fitimi i Shoqërisë dhe, ndarja e tijeteve për pa-
gat e punëtorëve, Shoqërisë i mbetet në dispozicion fitimi neto.

Neni 22

Fitimi neto ndahet mes Ortakëve mbi bazën e Vendimit të
Asamblesë së Ortakëve, nëpërmjet Administratorit të Shoqërisë, sipa-
rregullave të parashikuara administrative.

Neni 23

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen nëpërmjet kon-
tratës së punës. Për ato probleme që nuk rregullohen me kontratë pun-
do të zbatohen dispozitat e Legjislacionit Shqiptar.

~~Memëmbëreshkjet~~ midis punonjësve dhe Shoqërisë, zgjidhen
nga Gjykata Shqiptare. Kur pala ankuese është person i huaj, mosma-
rreveshja zgjidhet nga organi që është përcaktuar në kontratën për-
katëse.

Punonjësit nuk marrin pjesën e fitimit, të cilën e reali-
zon Shoqëria gjatë aktivitetit të saj, përveç rasteve kur është për-
caktuar ndryshe në kontratë. Për punën e tyre në Shoqëri, punonjësi
marrin pagën e tyre, e cila, pamvarësisht nga rezultatet e arritura
në punë, përcaktohet në kontratën e punës.

VII. KOHFZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 24

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë "ALBAN TOURIST", është
mbi 10 vjet.

Shoqëria merr fund :

-Në ato raste të parashikuara nga Legjislacioni Shqiptar,
si dhe kur Ortakët themelues, vendosin që të tërheqin mjetet e inves-
tuera në Shoqëri.

-Kur Shoqëria falimenton, ku hapet dhe procedura e likui-
dimit.

Neni 25

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar, me regjistrimin
e saj në Gjykatën e Rrethit të Tiranës dhe, pas paisjes me licencë
nga Zyrat e Taksa-Tatimeve të Rajonit Nr.1.

Neni 26

Kjo kontratë përpilohet në katër kopje në origjinat dhe, shumëfishimi i saj bëhet me marrëveshje ndërmjet Ortakëve.

Neni 27

Kjo kontratë hyn në fuqi dhe quhet e lidhur, ditën e nënshkrimit të saj nga Ortakët.

Tiranë, më _____ 1997

O R T A K E T

ISMAIL HOXHA

Ismail Hoxha
Ismail Hoxha

TEUTA HOXHA

Teuta Hoxha
Teuta Hoxha


REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E DREJTËSISE
NOTERIA TIRANË

Nr. 1527 Rep.

Nr. SKO Kol.

V E R T E T I M

Sot më datën 31/1 1997, u paraqitën para meje Zotërinjtë Ismail Hoxha dhe Teuta Hoxha, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova nga letërnjoftimet e tyre dhe, firmosën para meje Noteres Kontratën për krijimin e Shoqërisë Tregëtare "ALBAN TOURIST" dhe unë e vërtetoj rregullisht atë.



N O T E R E

MIRAZA SHEHU

Miraza Shehu

H Y R J E



Në mbështetje të Nenit 2, paragrafi i parë, shkronja "b" e ligjit Nr.75I2, datë 10.08.1991, "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë të veprimtarisë private të paruar dhe të privatizimit", të Dekretit Nr.7604, datë 31.07.1990, "Për veprimtarinë ekonomike të ndërmarjeve me pjesëmarrjen e kapitalit të huaj në Republikën e Shqipërisë" dhe, të dispozitave përkatëse të Kontratës për krijimin e Shoqërisë Tregëtare "ALBAN TOURIST

ne personat e poshtë shënuar :

1) Ismail Hoxha, i biri i Qshmanit, i datlindjes 25.11.194 me adresë banimi në Tiranë, Rruga Shihfjen Gjecovi n° 18, me letërnjoftimi AZ Nr. 0060487, lindur në Tiranë ;

2) Teuta Hoxha, e bija e Xhemalit, e datlindjes 14.01.1959 me adresë banimi në Tiranë, Rruga Shihfjen Gjecovi n° 18, me letërnjoftimi AZ Nr. 475790, lindur në Tiranë ,

hartuam këtë Statut të Shoqërisë Tregëtare "ALBAN TOURIST" SH.P.K. :

S T A T U T

I

SHOQËRISË TREGËTARE "ALBAN TOURIST"

I. DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Shoqëria në pronësi private "ALBAN TOURIST", nëpërmjet këtij statuti dhe, në përputhje me Kontratën për krijimin e saj, si dhe me Legjislacionin Shqiptar, rregullon pozitën juridike të Ortakëve dhe të punonjësve të saj, të dhëna me rëndësi për qarkullimin juridik, organizimin dhe objektin e veprimtarisë së Shoqërisë, si dhe çështjet e tjera me rëndësi për punën e kësaj Shoqërie.



Neni 2

Shoqëria është krijuar me Kontratën për krijimin e Shoqërisë Tregëtare në pronësi private, me kontributin nominativ të Ortakëve Themelues.

Neni 3

Shoqëria ka Statusin e personit juridik, Status që, përsa kohë nuk cënohet nga Ortakët Themelues, njehsohet me aktet ligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike të këtyre fushave.

Neni 4

Shoqëria "ALBAN TOURIST" është person juridik Shqiptar dhe si e tillë, vepron në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Selia legale e Shoqërisë është në Tiranë, Rruga Shkëlze

Ypesos Nr 18

Neni 5

Shoqëria ka vulën e saj, në të cilën është shkruar teksti: "SHOQËRIA TREGËTARE "ALBAN TOURIST" TIRANË". Fjala TIRANË është shkruar në mesin e rrethit.

Neni 6

Shoqëria ka intestimin e saj. Intestimi ka formën e katër-këndëshit kënd drejtë, me madhësi të zakonëshme, në skajin e sipërmë të të cilit është shkruar teksti :

"SHOQËRIA TREGËTARE "ALBAN TOURIST" TIRANË. Nëmes është shkruar shënja "Nr." me një vizë me shënjën S.L.P.K

Neni 7

Shoqëria fiton të drejtat e personit juridik, mbas lëshimit të autorizimit nga organi kompetent Shqiptar dhe, regjistrimit në organet gjyqësore dhe të financës Shqiptare.

Neni 8

Shoqëria "ALBAN TOURIST", zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me dispozitat e kontratës së lidhur midis Ortakëve dhe



konformë kërkesave të Legjislacionit Shqiptar.

Mosmarrëveshjet eventuale midis Ortakëve dhe midis Shoqërisë nga njera anë dhe, personave të tjerë fizikë dhe juridikë, Shqiptarë ose të huaj, do të zgjidhen sipas Legjislacionit Shqiptar.

Kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të parashikuara në paragrafin e mësipërmë, janë Gjykatat e Shtetit Shqiptar.

Neni 9

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë Private "ALBAN-TOURIST", është përcaktuar mbi 10 vjet, ku secili Ortak ka të drejtë të kërkojë zgjatjen e kontratës.

Kërkesa për zgjatjen e afatit të veprimtarisë, duhet paraqitur 3 muaj përpara përfundimit të këtij afati.

II. OBJEKTI I VEPRIMTARIËS

Neni 10

Shoqëria Private "ALBAN TOURIST", ka për objekt të veprimtarisë së saj :

Organizimin kryesisht të aktiviteteve turistike, brënda dhe jashtë Shqipërisë, për nënshtetas të huaj dhe vendas, duke marrë përsipër të gjitha shërbimet turistike që kërkohen si :

-Organizimi i udhëtimeve turistike brënda dhe jashtë vëndit.

-Rezervimi i vëndeve të fjetjes në hotele, motele, fshatra turistike e banesa private.

-Rezervime të restoranteve, sallave për takime e konferenca.

-Rezervime të të gjitha llojeve të mjeteve të transportit: tokësor, detar ajror.

-Organizim të vizitave në pika turistike, historike dhe arkeologjike.

-Organizimi i çfaqjeve artistike kulturore.

-Organizimi i aktiviteteve turistike sportive: ujore, mallore, ajrore.



-Transport turistik e pasagjerësh, bagazhë e mallra me mjete të veta transportuese tokësore, detare e ajrore.

-Marrje e dhënie me qira të mjeteve të transportit, shtëpi, hotele, bare, restorante e, objekte të tjera të ngjashme.

-Plotësimi i formaliteteve për marrjen e vizave turistike të klientave.

-Kryerje shërbimesh portuale dhe aeroportuale për anije, tragete e mjete të tjera lundruese dhe, mjete të transportit ajror, që kontraktin Shoqëria, gjithënjë në kuadrin e aktivitetit që ajo zhvillon.

-Mbarrshtrimi i faunës dhe florës, sipas plan-biznesit të Shoqërisë për interesa turistike, si dhe organizimi i gjuetisë turistike sportive.

-Kryerje shërbimesh konsulence e komisionere në fushën e turizmit e të aktiviteteve të tjera ekonomike sociale.

-Bashkëpunim e pjesëmarrje me partnerë vendas e të huaj në aktivitete dhe investime në fushën e turizmit dhe në fusha të tjera të lidhura me turizmin.

Neni 11

Për realizimin e kësaj veprimtarie, përveç qendrës në Qytetin e Tiranës, Shoqëria "ALBAN TOURIST" SH.P.K., mund të hapë degë, zyra, apo dhe filiale të saja, jashtë Selisë, duke u mbështetur në legjislacionin Shqiptar. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj, emërtimin dhe Selinë, vetëm me pajtimin e Ortakëve.

Neni 12.

Shoqëria "ALBAN TOURIST" SHPK, ushtron veprimtarinë e saj



për të realizuar fitimin, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit, si dhe vetëm mbi bazën e legjislacionit Shqiptar.

Shoqëria i ka të gjitha autorizimet në qarkullimin juridik me persona të tretë.

Neni 13

Për detyrimet e veta, të krijuara në veprimtarinë e saj me persona të tretë, shoqëria përgjigjet në bazë të pasurisë së vënë

III. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

Neni 14

Ortakët kanë këto të drejta kryesore :

[Signature]
-Të marrin pjesë në administrimin e veprimtarisë së Shoqërisë, në përputhje me përcaktimet që janë parashikuar në kontratën e themelimit dhe me përmbajtjen e këtij Statuti.

[Signature]
-Të marrin pjesë dhe të përfitojnë, konformë legjislacionit Shqiptar, në rezultatet ekonomiko-financiare të Shoqërisë, në të gjitha format dhe trajtat e këtyre rezultateve, si në sasi dhe në vlerë, në përputhje me kushtet e parashikuara në Kontratën e themelimit. Të përcaktojnë kompetencat e organeve administrative dhe ekzekutive të Shoqërisë.

-Të informohen në çdo kohë për të dhënat, në lidhje me rezultatet e veprimtarisë ekonomiko-financiare të Shoqërisë dhe, të njihen me dokumentacionin e plotë, në të cilin gjën pasqyrim kjo veprimtari. Secili prej Ortakëve ka të drejtë të marrë në dorëzim bilançin vjetor të aktivitetit ekonomiko-financiar, me qëllim që duke e njohur atë, të kontrollojë, përmirësojë dhe zhvillojë më tej këtë veprimtari.

-Çdo Ortak ka të drejtë të njihet (tashmë), në çdo kohë, me gjendjen e llogarisë Bankare të Shoqërisë dhe, mban përgjegjësi para Ortakëve të tjerë, deri në përjashtimin nga Shoqëria, si dhe përpara Asamblesë së Shoqërisë, për dekonspirimin e saj në persona të tretë, jashtë kontraktuesve dhe personave të tjerë, të autorizuar nga Asamblea e Shoqërisë.

[Signature] %



-Çdo Ortak ka të drejtë të bëjë propozime për organizimin e punës, me qëllim që të përmirësohet vazhdimisht mbarëvajtja e punës së Shoqërisë. Të marrë pjesë në shqyrtimin e këtyre propozimeve në mbledhjen e Asamblesë.

-Secili nga Ortakët ka të drejtë të heqë dorë (të dalë) nga Shoqëria, por pasi të plotësojë kushtet e parashikuara në kontratën themeluese.

Këto të drejta Ortakët i gëzojnë njëjloj dhe në mënyrë të barabartë.

Të drejtën e firmës për llogarinë bankare të Shoqërisë, e ka vetëm Administratori i saj, si dhe çdo person tjetër i autorizuar prej tij, ose i caktuar nga Asambleja. Ky autorizim duhet të jetë me shkrim, firmën dhe vulën e Shoqërisë.

Ortakët kanë këto detyrime kryesore :

-Të respektojnë e themelimit të Shoqërisë "ALBAN TOURIST" dhe Statutin e saj

-Të depozitojnë pjesën e kapitalit sipas Nenit 9 të Kontratës themeluese të Shoqërisë. Kjo të bëhet menjëherë pas regjistrimit të Shoqërisë si person juridik, në organet financiare Shqiptare

-Të informojnë reciprokisht njëri-tjetrin për veprimtarinë ekonomiko-financiare, që zhvillojnë në dobi të Shoqërisë.

IV) MJETET E SHOQËRISË

Neni 15

Kapitali Themelor i Shoqërisë përkrijimin dhe fillimin e punës së shoqërisë, në përputhje me Kontratën Themeluese Ortakët i sigurojnë në shumën prej 500.000 lekë.

I gjithë kapitali themeltar ndahet në 100 kuota (5000 lekë çdo kuota).

Pjesëmarrja e Ortakëve në këto pjesë dhe në kontribute është :

1) Ismail Hoxha kontribon me 255.000 lekë dhe disponon kuotat nga Nr.1 deri në 51 të serisë ;

2) Teuta Hoxha kontribon me 245.000 lekë dhe disponon

kuotat me Numur Serie 52, deri në 100 të Serisë.

Kuotat që vërtetojnë kontributin fillestar të Ortakëve Themelues, janë të disponueshme dhe të kundërfirmosura midis palëve, në prani të një Noteri.



Mjetet e përmëndura në paragrafin e mësipërmë të këtij Neni, Ortakët do ti paguajnë tek Noteri që vërteton këtë Statut.

Shoqëria private "ALBAN TOURIST" SH.P.K., në një nga Bankat, do të ketë numur llogarie të vetin.

Neni 16

Zgjerimi i mëtejshëm i aktivitetit të Shoqërisë, do të bëhet me dënimin dhe pëlqimin e Ortakëve.

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 17

Ortakët drejtojnë veprimtarinë e Shoqërisë, duke u mbështetur në të drejtën e tyre të pronësisë private në mjetet e investuara në Shoqëri.

Neni 18

Secili nga Ortakët ka të drejtën e largimit nga Shoqëria dhe ke vënë në shitje kuotat e tij. Njoftimi për largim nga Shoqëria, bëhet 30 ditë më parë. Pas kalimit të këtij afati, Ortaku tjetër detyrohet të ushtrojë të drejtën e parablerjes së kuotave, që i afrohen, ose të deklarojë se e refuzon këtë të drejtë, duke lejuar shitjen e tyre tek të tretët, me të njëjtën vlerë.

Ortaku që largohet në bazë të kësaj procedure, krahas marrjes së pjesës së fitimit, detyrohet që për pjesën takuese në Shoqëri, të bëjë edhe shlyerjen e të gjithë detyrimeve që i takojnë, deri në momentin e largimit.

Ortakët, për çdo rrethanë financiare, që mund të lindë midis tyre apo të tretëve, përgjigjen brënda pasurive që ka Shoqëria "ALBAN TOURIST" SH.P.K.

NENI 19

Në rast se Shoqërisë i vjen një dëm efektiv për shkak të njerit prej Ortakëve, ai do të përgjigjet sipas Legjislacionit penal dhe civil Shqiptar, për shlyerjen e këtij dëmi.



Neni 20

Shoqëria kryen veprimtarinë e vet me mjetet e investuara në fondet e saja dhe me mjetet e tjera. Ajo është e detyruar, që vëllimin e punës së vet, ta ushtrojë në vartësi me shumën e mjeteve të investuara në fondin themeltar të Shoqërisë dhe, nga shuma e mjeteve të rezervës.

Shoqëria përcakton fondet e mëposhtëme :

- 1) FONDIN THEMELTAR
- 2) FONDIN REZERVE

Për ushtrimin e veprimtarisë së vet, Shoqëria mund të caktojë dhe fonde të tjera.

Neni 21

Fondin themeltar formohet nga mjetet e investuara nga Ortakët dhe nga mjetet e tjera në para, ose në formë tjetër, të investuara nga persona të tjerë.

Shoqëria shfrytëzon fondin themeltar për ushtrimin e veprimtarisë së saj, për investime në fondet e personave të tjerë juridik e fizik, si dhe për të përballuar rreziqet, pas shfrytëzimit të mjeteve të rezervës. Gjithashtu mund ti shfrytëzojë edhe për destinime të tjera sipas interesit të Shoqërisë.

Neni 22

Fondi rezerve i Shoqërisë formohet nga një pjesë e fitimit, që Shoqëria e realizon gjatë veprimtarisë së saj. Ajo përcaktohet me një Vendim të veçantë të Asamblesë së Shoqërisë. Fondi rezervë mund të përdoret edhe për destinime të tjera, që janë në përputhje me interesat e Shoqërisë.

Pas miratimit të bilancit dhe raportit financiar vjetor nga Asambleja e Shoqërisë, pjesa e fitimit neto, mund të ndahet vetëm me Vendim të Asamblesë, në masa të tilla, që i shërbejnë përmirësimit dhe zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë, por pasi të ketë hequr shpenzimet përkatëse, që futen në fitimin e çdo Ortaku.

VI. ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

[Handwritten signature and initials]



Neni 23

Organet drejtuese të Shoqërisë private "ALBAN TOURISTE janë :

- Asambleja e Shoqërisë, që përbehet nga Ortakët.
- Administratori i Shoqërisë që caktohet nga Asambleja e Ortakëve.
- Drejtori i Shoqërisë, që caktohet me Vendim të Asamblesë si organ administrativ i Administratorit.

Neni 24

Asambleja e Ortakëve, është organ më i lartë i Shoqërisë. Ajo zgjedh ose cakton Administratorin dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Shoqërisë dhe, në mungesë të tyre, emëron provizorisht zëvendësit përkatës.

Neni 25

Vendimet e Asamblesë marrin fuqi ekzekutive, vetëm pasi të jenë miratuar në mënyrë kolegjiale nga Asambleja. Ajo vendos me ndërhyrjen me votë favorizuese, me të paktën 51 % të kapitalit. Asambleja mbledhet një herë në vit dhe, të paktën një herë në katër muaj, bën bilançin e veprimtarisë së Shoqërisë.

Neni 26

Asambleja e Shoqërisë ka këto kompetenca :

- Si organi më i lartë i Shoqërisë, organizon, drejton dhe kontrollon të gjithë veprimtarinë ekonomiko-financiare të Shoqërisë.
- Nxjerr planin dhe programin e zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë dhe akte të përgjithëshme, që i shërbejnë këtij programi, nxjerr Vendimin për ndryshimin e emërtimit, selisë dhe objektit të veprimtarisë së Shoqërisë.
- Vendos për rritjen ose pakësimin e fondit themeltar të Shoqërisë, si dhe përcakton fondin rezervë.
- Jep udhëzime dhe porosi të nevojshme, si dhe orienton punën e Administratorit të Shoqërisë.
- Miraton bilançin dhe raportin financiar të Shoqërisë.
- Vendos për ndarjen dhe përdorimin e fitimit, si dhe për mbulimin e humbjeve dhe të rreziqeve eventuale.



-Vendos për ndryshimin e formës së Shoqërisë (organizimit të saj).

-Vendos për mbylljen e aktivitetit të Shoqërisë, si dhe për kohëzgjatjen e saj, tej afatit të përcaktuar në Kontratën themeluese.

-Emëron dhe shkarkon Administratorin dhe Drejtorin e Shoqërisë.

-Drejton dhe punë të tjera të rëndësishme, që i shërbejnë afarizmit të Shoqërisë.

-Vendos për ndryshimet eventuale në Statut.

Neni 27

Administratori i Shoqërisë përgjigjet për punën e tij, para Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë. Ai emërohet ose shkarkohet dhe me propozimin e Ortakut që ka kapitalin më të math. Mandati i Administratorit nuk është i kufizuar, përveç rasteve kur ai ndërpritet me Vendim të Asamblesë.

Neni 28

Administratori i Shoqërisë mund të zëvendësohet përkohësisht nga një person tjetër dhe, si rregull përcaktohet Drejtori i Shoqërisë, i cili gëzon ato kompetenca, që i delegon Administratori në mënyrë të shkruar, përjashtuar kompetencën e përfundimit të kryeveprave dhe kontratat me të tretët.

Neni 29

Administratori i Shoqërisë drejton gjithë veprimtarinë e saj, në përkrahjen tekniko-organizative, duke patur këto kompetenca:


-Organizon dhe drejton veprimtarinë e Shoqërisë dhe afarizmin e saj, në bazë të udhëzimeve, porosive dhe orientimeve të marra nga Asambleja e Shoqërisë.

-Përfaqëson Shoqërinë ndaj personave të tretë.

-Përgjigjet para Asamblesë për ligjëshmërinë e punës së Shoqërisë, si dhe për aktivitetin ekonomik e financiar të saj.

-Propozon për ndryshime në organizimin e punës së Shoqërisë, emëron dhe shkarkon punonjësit që ka në vartësi.

-Mund të pezullojë në çdo kohë Drejtorin e Shoqërisë dhe, të miratojë në Asamblesë e Shoqërisë, masat disiplinore dhe admini-



strative, që lidhen me Drejtorin e Shoqërisë.

-Përsa kohë Shoqëria ndodhet pa Drejtor, për shkak të pezullimit nga detyra, komandon një person tjetër, por jo më shumë se 60 ditë afat kohor, që shërben për marrjen e aprovimit nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve, ose dhe nëpërmjet konsultimeve të veçanta me Ortakët e Shoqërisë, që njësohen me Vendimin e Asamblesë së Ortakëve.

-Ka të drejtë të lidhi kontrata, të kryejë punë e veprimtari të tjera juridike, brenda autorizimeve të dhëna nga Asambleja dhe, pa kushte të ketë marrë pëlqimin e saj. Ky pëlqim mund të jepet edhe me gojë.

-Përcakton, sipas një miratimi paraprak në Asamblesë së Ortakëve, strukturën organizative të Shoqërisë, kompetencat e Drejtorit të saj, si dhe të drejtuesve të tjerë të sektorëve të veçantë.

Neni 30

Administratori mund të shkarkohet :

-Me kërkesën e tij.

-Kur Asambleja vërteton që ai është përgjegjës për mos arritjen e rezultateve afariste të Shoqërisë.

-Në rastet e tjera të parashikuara me ligj.

Neni 31

Forma e bilanceve dhe librave të llogarisë që do të mbahen në Shoqëria, përcaktohen nga Asambleja e Shoqërisë.

VII. NDARJA E FITIMIT

Neni 32

Fitimi i Shoqërisë përcaktohet nga bilanci 4 mujor i veprimtarisë ekonomiko-financiare të Shoqërisë.

Neni 33

Pas përballimit të detyrimeve, pagave, taksave, tatimeve dhe, shpenzimeve të tjera nga fitimi i Shoqërisë, asaj i mbetet në dispozicion fitimi neto, i cili ndahet sipas kontributit dhe, ashtu siç parashikohet në Kontratën e Themelimit, Neni _____.



Neni 34

Në qoftë se në bilançin 4 mujor, Shoqëria nuk del me fitim, por me humbje, humbjet do të mbulohen në përputhje me kuotën e investuar, me rastin e krijimit të Shoqërisë. Nëse mbas kryerjes së veprimit të parashikuar nga paragrafi i mësipërmë, nuk do të mbulohet kjo humbje, atëherë ndaj Shoqërisë hapet procedura e likuidimit (falimentimit), në rast se vazhdimi i mëtejshëm i aktivitetit të saj ekonomiko-financiar, është i pamundur.

VIII. ORGANIZIMI I BRËNDSHËM I SHOQËRISË

Neni 35

Shoqëria kryen veprimtarinë e saj me anë të njësi organizative, që cakton ajo vetë (Asambleja e Shoqërisë). Këto njësi organizative quhen Sektorë. Sektorët nuk kanë status të personit juridik, as autorizime në qarkullim juridik me personat e tretë.

Sektorët drejtohen nga Administratori i Shoqërisë, i cili mund të tëmërojë të gjitha organikat administrative të Shoqërisë. E gjithë struktura administrative, për detyrat funksionale që kryen, jep llogari para Administratorit dhe Drejtorit të Shoqërisë.

IX. MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 36

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen në përputhje me kontratën për krijimin e Shoqërisë, Legjislacionit Shqiptar dhe me këtë Statut.

Neni 37

Me kontratën e punës rregullohen këto çështje :

- Kushtet dhe menyra e krijimit të marrëdhënieve të punës.
- Fillimi i punës së punonjësit (koha) dhe, caktimi i tij në vëndin e punës.
- Caktimi i kohës së punës, puna gjatë natës, puna jashtë kohës normale të punës, puna në ditët e pushimit javor dhe festave zyrtare e fetare.



-Mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, sigurimet shoqërore, paga.

-Pushimet dhe mungesat, të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësia e punonjësit, për zbatimin e detyrave të tij.

-Mënyrën e pushimit të marrëdhënies së punës.

Neni 38

Punonjësit për punën e tyre marrin pagën, e cila është në varësi të rezultateve të arritura në punë, në përputhje me kontratën e punës. Në kontratën e punës caktohen : paga e punonjësit, shpërblimi mbi pagë, si dhe shpërblime të tjera.

X. PËRGJEGJËSIA E PUNONJËSVE

Neni 39

Punonjësi është personalisht përgjegjës për kryerjen e punës së caktuar në kontratë dhe, zbatimin e detyrave, në mënyrë të ligjshme dhe profesionale.

Drejtori është përgjegjës për kryerjen e punëve që rrjedhin nga kompetencat e tij.

Neni 40

Administratori, Drejtori, Përgjegjësat e Sektorëve dhe punonjësit e tjerë të Shoqërisë, bartin dhe përgjegjësinë materiale, për marrjen e Vendimeve jo ligjore, të cilat dëmtojnë materialisht Shoqërinë, Ortakët si themelues të Shoqërisë, në varësi nga ndikimi i tyre, për marrjen dhe zbatimin e vendimeve të tilla.

Të gjithë personat e mësipërmë, të parashikuar në paragrafin e parë të këtij Neni, në rast se nga veprimet e tyre është shkaktuar dëm, që formon vepër penale, do të përgjigjen sipas Legjislacionit Penal Shqiptar dhe do të gjykohen nga Gjykatat Shqiptare dhe, për dëmin civil, do të përgjigjen sipas



Neni 41

Sekreti i punës së Shoqërisë është i detyrueshëm të ruhet nga të gjithë punonjësit e saj.

Neni 42

Sekrete të punës paraqesin shkresat, aktet dhe Vendimet e nxjerra nga Asambleja dhe që janë të shpallura prej saj si sekrete të punës. Për shkelje të Nenit 41, si masë merret largimi nga puna i punonjësit dhe, në rast se nga kjo shkelje, Shoqëria ka patur dëm material efektiv, personi fajtor do të përgjigjet sipas Legjislacionit Penal e Civil Shqiptar.

XI. KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 43

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë "ALBAN TOURIST" parashikohet mbi 10 vjet. Ay mund të zgjatet me Vendim të Asamblesë së Shoqërisë.

Shoqëria merr fund në rastet e përcaktuara nga Legjislacioni Shqiptar, në bazë të Vendimit të Asamblesë dhe, kur hapet procedura e likuidimit, përkatësisht e falimentimit.

Neni 44

Shoqëria fiton zotësinë për të vepruar, me regjistrimin e saj në Gjykatën e Rrethit Tiranë, ku ndodhet dhe Regjistri Tregëtar.

XII. DISPOZITA E FUNDIT

Neni 45

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti, bëhen

në të njëjtën mënyrë dhe procedurë, me të cilën nxirret ky Statut.

Propozimin për ndryshimet dhe plotësimet e Statutit, mund të japi secili prej Ortakëve të Shoqërisë "ALBAN TOURIST" SH.P.K. Ky propozim duhet të jepet me shkrim.

NENI 46

Ky Statut hyn në fuqi ditën e miratimit nga Ortakët e Shoqërisë dhe nënshkrimi prej tyre.

Tiranë, më _____ 1997

O R T A K Ë T

ISMAIL HOXHA

Ismail Hoxha
Ismail Hoxha

TEUTA HOXHA

Teuta Hoxha
Teuta Hoxha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA TIRANË

Nr. 1528 Rep.

Nr. 501 Kol.

V È R T E T I M

Sot më datën 5/1/ 1997, u paraqitën para meje Noteres Zotërinjtë : Ismail Hoxha dhe Teuta Hoxha, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilëve u sigurova nga letërnjoftimet e tyre dhe, firmosën para meje Statutin e Shoqërisë Tregëtare "ALBAN TOURIST" dhe unë e vërtetoj rregullisht atë.



N O T E R E

MIMOZA SHEHU

Mimoza Shehu